



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 840/5 prot.

Tiranë, më 17.07.2019

REKOMANDIM

Nr. 32, datë 17.07.2019

PËR KONTROLLUESIN "ORION SH.P.K."

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 pika 1 gërma a/1 dhe 32 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Orion sh.p.k.*";

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 170, datë 27.05.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "*Orion sh.p.k.*" me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi "*Orion sh.p.k.*".

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "*Orion sh.p.k.*" konstatoi se:

1. Kontrolluesi "*Orion sh.p.k.*" operon në sektorin e ndërtimit prej 20 vitesh. Kategoritë e subjekteve të cilëve ju përpunohen të dhënat personale janë "*punëmarrës*", "*klientë*" dhe "*vizitorë*".
2. Kontrolluesi ka miratuar "*Politikën e Sigurisë së Informacionit*", qëllimi i së cilës është mbrojtja nga ndërhyrjet e paautorizuara në asetet e informacionit të cilat mund të cenojnë veprimtarinë dhe reputacionin e "*Orion sh.p.k.*". Konstatohet se përmbajtja e politikës është e kufizuar dhe nuk reflekton detyrimet ligjore sipas kategorive specifike të të dhënave personale që përpunon kontrolluesi, etj.

Duhet kuptuar drejt nga kontrolluesi rëndësia që ka hartimi i një rregulloreje të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe përdorimi i saj nga nëpunësit e tij, si një akt bazë i cili ndërgjegjëson dhe detyron punonjësit për ruajtjen e konfidencialitetit, ruajtjen nga keqpërdorimi dhe mënyrën e administrimit të të dhënave personale.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", pika 2/1: "Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat teknike-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera.", dhe Vendimit nr. 6/2012 i Komisionerit "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale".

3. Në pikën 2.4 të kontratës me punëmarrësit, është parashikuar detyrimi i punëmarrësit për mos-përhapjen e të dhënave të klientëve apo çdo informacioni tjetër të punëdhënësit, megjithatë kontrolluesi ka marrë masa për të nënshkruar "Deklaratën e Konfidencialitetit" me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale.

4. Kontrolluesi disponon një sistem video-survejimi, nëpërmjet të cilit mbikëqyr hyrjen e jashtme të godinës në të cilën ushtron aktivitetin, me qëllim sigurinë e pronës dhe ambienteve fizike në të cilin ushtron aktivitetin. Koha e ruajtjes së imazheve-video është 50 ditë. Kontrolluesi nuk informon subjektet e të dhënave, mbi përpunimin e të dhënave personale imazhe-video, ushtrimin e të drejtës së subjekteve të të dhënave në rast të cënimit të privatësisë, etj.

Mungesa e informimit të subjekteve të të dhënave lidhur me mbikëqyrjen e ambienteve nëpërmjet sistemit të video-survejimit (CCTV), përbën shkelje administrative të nenit 18, pika 1 të Ligjit: "Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhëna personale" dhe Udhëzimit Nr.3/2010 të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera".

5. Kontrolluesi disponon një kontratë me shoqërinë tregtare "Klinika e punës shpk" me objekt: "Ofrimin e konsulencës mjekësore të shërbimit të kontrollit shëndetësor në punë...". Në pikën 11 të kontratës, është parashikuar "Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale", megjithatë konstatohet se nuk janë parashikuar kriteret e parashikuara në nenin 20 të ligjit dhe Udhëzimin nr.19/2012 të Komisionerit "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave...".

Konstatimi përbën shkelje të nenit 20 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 19/2012 të Komisionerit "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit ..." i ndryshuar.

6. Kontrolluesi kryen transferim ndërkombëtar për kategoritë e subjekteve të të dhënave "punëmarrës", me qëllim organizimin e udhëtimeve turistike dhe trajnimeve apo pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare.
7. Kontrolluesi kryen marketing të drejtpërdrejtë nëpërmjet postës elektronike email, nëpërmjet kontraktimit të palëve të treta. Marketingu është në formën e dërgimit të email-it reklamues drejt adresave të email-it që disponon pala e tretë dhe jo klientëve të "Orion shpk".

Me qëllim ofrimin e produkteve dhe shërbimeve, kontrolluesi mund të kryejë marketing të drejtpërdrejtë edhe nëpërmjet instrumenteve elektronike të tilla si posta elektronike (email), referuar pikës 5 të nenit 6 të ligjit: "Mbledhja e të dhënave personale, që lidhen në mënyrë unike me një subjekt të dhënash, për arsye të tregtimit të drejtpërdrejtë, lejohet vetëm nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e shprehur qartë.". Gjatë kontrollit administrativ, është konstatuar se marketingu i drejtpërdrejtë nuk është zhvilluar në respekt të parimeve të nenit 6 të ligjit, konstatuar një gjë e tillë në komunikimin elektronik me palën e tretë e cila ofron një shërbim të tillë.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 6 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 16/2011 "Për mbrojtjen e të dhënave personale në tregtimin e drejtpërdrejtë dhe masat e sigurisë".

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës i cili u nënshkrua edhe nga përfaqësuesi i kontrolluesit, mbasi parashtrori komentën se: "Pretendimet do të paraqiten me shkrim". Një kopje e procesverbalit iu vu në dispozicion përfaqësuesit të kontrolluesit.

Në datën 25.06.2019, kontrolluesi paraqiti pranë Zyrës së Komisionerit pretendimet me shkrim si më poshtë vijon:

- Sa i përket konstatimit në lidhje me hartimin e rregullores për përpunimin e të dhënave personale, "Orion shpk" do të nisë procesin e redaktimit të saj në bazë të rekomandimeve përkatëse;
- Konstatimi sa i përket mungesës së informimit të subjekteve mbi përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video-surveimit (CCTV), ju informojmë se bëhet fjalë vetëm për "hyrjen e jashtme të zyrave", kamera fokusohet ngushtësisht vetëm në derën e hyrjes së ORION dhe gjithashtu "ORION sh.p.k." në mjediset e brendshme të zyrave të tij nuk ka survejim me kamera.
- Konstatimi sa i përket ofrimit të shërbimit nga shoqëria "Klinika e punës sh.p.k.", neni 11 i kontratës, i dedikohet pikërisht dhe vetëm mbrojtjes së të dhënave personale. ORION do të fillojë procesin e përmirësimit të kësaj pike të kontratës (nenit 11) për ta hartuar atë më në përputhje me dokumentet ligjore të sipërcituara;
- Konstatimi sa i përket dërgimit të e-maileve reklamuese, për çdo adresë e-mail që dërgohet nga "ORION shpk" në raste të tilla, përmbahet qartazi rubrika "Unsubscribe". Pra, të gjithë klientët e kanë mundësinë e çregjistrimit nga lista jonë e dërgimit të e-maileve. Kjo është praktikë, që në vlerësimin tonë, përdoret nga shumë kompani vendase madje edhe ndërkombëtare, dhe këtë gjë e kemi përdorur mbi bazën e modelit të mësipërm.

Në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", kontrolluesi "Orion sh.p.k." është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit. Kontrolluesi është paraqitur në seancë dhe ka dokumentuar pjesërisht rikuperimin e shkeljeve administrative të konstatuara në kontrollin e ushtruar pranë tij.

Sa i përket pretendimit në lidhje me përpunimin e të dhënave imazhe-video nëpërmjet sistemit të video-survejjimit (CCTV), Zyra e Komisionerit vlerëson se kontrolluesi "Orion sh.p.k." është përgjegjës për zbatimin e masave teknike dhe organizative për funksionimin e tij. Përpunimi i të dhënave imazhe-video nëpërmjet sistemit të video-survejjimit (CCTV) është i rregulluar, pra i ligjshëm në rast se respektohen kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave sipas dispozitave të parashikuara në nenin 6 të ligjit. Kontrolluesi duhet të zbatojë gjithashtu kriteret e përcaktuara në nenin 18 të ligjit, në lidhje me informimin e subjekteve të të dhënave për t'iu mundësuar të drejtat që parashikon ligji. Zyra e Komisionerit ka hartuar dhe publikuar në fletoren zyrtare Udhëzimin nr. 3/2010 "Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", nëpërmjet të cilit është miratuar edhe tabela standarde për informimin e subjekteve mbi përpunimin e të dhënave, si dhe mundësinë e ushtrimit të të drejtave të tyre.

Sa i përket delegimit të përpunimit të të dhënave sensitive "shëndetësore" të punëmarrësve, kontrolluesi duhet të ketë në vëmendje respektimin e dispozitave ligjore të përcaktuara në Kreun II dhe nenin 20 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Udhëzimin nr.11/2011 "Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat" si dhe Udhëzimin nr.19/2012 të Komisionerit "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave...".

Sa i përket marketingut të drejtpërdrejtë nëpërmjet postës elektronike (email), në adresat elektronike të subjekteve të të dhënave të cilët nuk kanë dhënë "pëlqimin", Zyra e Komisionerit vlerëson se ky përpunim është bërë jo në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 6 të ligjit.

"Pëlqimi", është një nga 6 principet ligjore për përpunimin e të dhënave personale, parashikuar në pikën 1 të nenit 6 të ligjit. Në rastin kur kontrolluesi fillon një përpunim të dhënash (në rastin konkret marketingun e drejtpërdrejtë), ai duhet të konsiderojë se cila është baza e përshtatshme ligjore për vazhdimin e përpunimit. Në përgjithësi, "pëlqimi" mund të jetë një bazë ligjore e përshtatshme, nëse subjektit të të dhënave i është ofruar kontroll, si dhe i është ofruar mundësi e qartë për të pranuar apo refuzuar termat e ofruara, ose t'i refuzojë i pakushtëzuar. Kur kërkon "pëlqimin", kontrolluesi duhet të vlerësojë nëse ai plotëson të gjitha kërkesat për të garantuar një "pëlqim" të vlefshëm. Nëse është marrë në përputhje me ligjin, "pëlqimi" është një mjet që i mundëson subjektit të të dhënave kontroll nëse të dhënat e tij personale do të përpunohen apo jo. Në rast se jo, kontrolli i subjekteve mbi përpunimin e të dhënave, do të ishte imagjinar dhe "pëlqimi" do të ishte një bazë ligjore jo e saktë për përpunimin, duke e bërë procesin e përpunimit të paligjshëm.

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit me grupin e kontrollit dhe reagimin e tij për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 6, 7, 18, 20, 27, 29, 30, 31 pika 1, gërma a/1 dhe 32 të ligjit nr. 9887/2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi *"Orion shpk."*, të ketë në vëmendje përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave, si dhe të drejtat ligjore që gëzojnë subjektet e të dhënave, në zbatim të nenit 18 të ligjit nr.9887/2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar.
2. Kontrolluesi *"Orion shpk."*, në cilësinë e kontrolluesit, të ketë në vëmendje përpunimin e të dhënave të punonjësve në përputhje me dispozitat ligjore të përcaktuara në Kreun II të ligjit nr.9887/2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.11/2011 *"Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat"*.
3. Kontrolluesi *"Orion shpk."*, në cilësinë e kontrolluesit, të përfshijë në marrëveshjet me përpunuesit, detyrimet e parashikuara në nenin 20 të ligjit nr.9887/2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.19/2012 të Komisionerit mbi *"Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi"*.
4. Kontrolluesi *"Orion shpk."*, të hartojë rregulloren e brendshme në të cilën të parashikohen masa konkrete organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat dhe aksesin në të dhëna, të drejtat e subjekteve të të dhënave etj., në zbatim të nenit 27 të ligjit nr.9887/2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar dhe Vendimit nr. 6/2012 të Komisionerit *"Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale"*.
5. Kontrolluesi *"Orion shpk."*, të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda një afati 30 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përmbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
6. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të ligjit nr. 9887/2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet

administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

7. Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 17.07.2019

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

